

VENDIM
Nr. 687, datë 22.11.2017

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT VJETOR
TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, QË DO T'U PAGUHET PRODHUESVE
EKZISTUES ME PËRPARËSI

(ndryshuar me VKM nr. 396, datë 13.5.2020, nr. 67, datë 8. 2. 2023)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 22, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Metodologjia për llogaritjen e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, përcaktohet në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi. Prodhuesit ekzistues me përparësi janë prodhuesit me përparësi, që, në bazë të pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, janë pajisur me certifikatën e pranimi të veprës së centralit elektrik, brenda datës 31 dhjetor 2020.

2. Kriteret ku bazohet metodologjia për llogaritjen e çmimit, sipas pikës 3 të këtij vendimi, janë si më poshtë:

a) “Referenca në çmimin e tregut të vitit përkatës të bursës hungareze HUPX të energjisë elektrike”, që përfaqëson çmimin mesatar vjetor të tregut të ditës në avancë (HUPX DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) të bursës së Hungarisë HUPX, ashtu siç publikohet në raportin vjetor të kësaj burse për këtë produkt.

b) “Referenca në normën mesatare e shkëmbimit euro/lekë të vitit të fundit”, që përfaqëson kursin mesatar vjetor të këmbimit nga euro/lekë, i publikuar nga Banka e Shqipërisë për vitin përkatës.

c) “Bonusi për promovimin e burimeve të rinovueshme”, që merr në konsideratë:

i) normën mesatare të kthimit të arsyeshëm të vlerës së investimeve të burimeve të rinovueshme, reduktimin e humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, si pasojë e furnizimit të energjisë elektrike në pikat e lidhjes së këtyre hidrocentraleve me rrjetin energjetik të tensionit të lartë dhe/ose të mesëm;

ii) kostot e shmangura të shërbimit të transmetimit;

iii) kostot e alokimit të kapaciteteve të interkoneksionit të energjisë nga importi.

ç) “Niveli minimal i çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike”, në çdo rast, nuk do të jetë më i ulët se i çmimit të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë për vitin 2016 për këta prodhues.

d) *Niveli maksimal i çmimit të llogaritur të blerjes së energjisë elektrike”, në çdo rast, nuk do të jetë më i lartë se çmimi 10 lekë/kWh (pa TVSH).*

3. Metodologjia për llogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është si më poshtë:

Çmimi vjetor i blerjes (lekë/kwh) = Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX DAM), i energjisë elektrike në profilin bandë (*baseload*) i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kwh x bonusin për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.20 x normën mesatare të këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

4. Ngarkohet ministria përgjegjëse për energjinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama